

VENDIM

Nr. 805, datë 30.9.2015

PËR KUSHTET DHE MËNYRËN E MBROJTJES SË VEÇANTË TË PUNONJËSIT TË POLICISË USHTARAKE NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, KUR, PËR SHKAK TË DETYRËS, I KËRCËNOHEN JETA, FAMILJA DHE PRONA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42, të ligjit nr. 13/2015, "Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit të Policisë Ushtarake, që, për shkak të detyrës, i kërcënohen jeta, familja dhe prona, i sigurohet mbrojtje e veçantë nga Policia Ushtarake.
2. Me mbrojtje të veçantë sipas këtij vendimi nënkuptohen masat me karakter organizativ e profesional për sigurimin dhe ruajtjen e veçantë fizike, mbrojtjen e familjes e të pronës së punonjësit.
3. Punonjësi i kërcënuar paraqet kërkesë me shkrim për mbrojtje të veçantë të shoqëruar, sipas rastit, me certifikatën familjare. Kërkesa me shkrim duhet të përmbajë:
 - a) gjenealogjetet e plota të punonjësit;
 - b) faktet dhe rrethanat, që përbëjnë rrezik për punonjësin, si dhe burimin e provave ku bazohen ato;
 - c) llojin e masës mbrojtëse dhe kohëzgjatjen e saj.
4. Kushtet për të përfutuar mbrojtje të veçantë janë:
 - a) Ekzistenca e rrethanave që rrezikojnë jetën, familjen dhe pronën e punonjësit;
 - b) Ekzistenca e lidhjes shkakësore ndërmjet rrethanave dhe ushtrimit të detyrës nga punonjësi.
5. Për vlerësimin e kërcënimit dhe për mënyrën e sigurimit të mbrojtjes, ngrihet një komision i posaçëm i cili përbëhet nga:
 - a) Komandanti i Policisë Ushtarake kryetar;
 - b) Zëvendëskomandanti i Policisë Ushtarake anëtar;

- c) Shefi i Shtabit të Policisë Ushtarake anëtar;
- ç) Shefi i Policisë Gjyqësore anëtar;
- d) Shefi i Policisë Kriminale anëtar;
- dh) Shefi i Operacioneve anëtar;
- e) Eprori i drejtpërdrejtë i punonjësit të kërcënuar anëtar;
- ë) Shefi i personelit sekretar.

6. Komisioni duhet të mbledhet jo më vonë se 48 orë nga data e paraqitjes së kërkesës për mbrojtje të veçantë, ku vendos pranimin ose jo të kërkesës dhe marrjen e masave të menjëhershme për të garantuar jetën, familjen ose pronën e punonjësit, sipas rastit. Në vendim përcaktohen, sipas rastit, masat konkrete të mbrojtjes së veçantë, afati brenda të cilit sigurohet mbrojtja, si dhe masa të tjera të nevojshme.

7. Masat konkrete për mënyrën e mbrojtjes së veçantë janë:

- ruajtja fizike;
- ruajtja e banesës ose e pronës;
- transferimi i punonjësit;
- dërgimi jashtë shtetit i punonjësit;
- masa të tjera, në varësi të çështjes.

8. Mbledhjet e komisionit janë të vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se katër anëtarë të tij. Vendimet janë të vlefshme kur miratohen të paktën nga katër anëtarë, të pranishëm në mbledhje.

9. Në rastet kur nevojitet marrja e menjëhershme e masave të mbrojtjes së veçantë, kjo bëhet me urdhër të Komandantit të Policisë Ushtarake, deri në marrjen në shqyrtim nga komisioni i vlerësimit.

10. Vendimi i komisionit të vlerësimit zbatohet nga Komandanti i Policisë Ushtarake dhe brenda 3 (tri) ditëve vihen në dijeni Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe ministri i Mbrojtjes.

11. Kundër vendimit të komisionit të vlerësimit, i interesuari mund të bëjë ankim, brenda 5 (pesë) ditëve te Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, i cili vendos lënien në fuqi ose ndryshimin e vendimit.

12. Shpenzimet për mbrojtjen e veçantë të punonjësit të kërcënuar përballohen nga buxheti për Policinë Ushtarake.

13. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Policia Ushtarake për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama